

POLITIKA E ANGAZHIMIT TË PRINDËRVE TË MBARË DREJTORISË ARSIMORE PËR VITIN 2014-2015

* * * * *

PJESA I. OBJEKTIVAT E PRITËSHME

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS (DAF) është e përkushtuar drejt bashkëpunimit me prindërit dhe familjet dhe ka vënë në zbatim një numër programesh, shërbimesh dhe nismash, me qëllim që:

- Të mbështesë përfshirjen e prindërve dhe pjesëmarrjen e tyre në nivel shkollash, rajonal dhe në mbarë Drejtorinë,
- Të ftojë prindërit dhe komunitetin që të japin mendimet e tyre në vendimmarrjet e shkollës dhe Drejtorisë Arsimore,
- Të zgjerojë aksesin në informacion dhe
- Të ofrojë mbështetje më të mirë në zgjidhjen e shqetësimeve të prindërve dhe ndërtojë kapacitetet prindërore për drejtim dhe mbrojtje të fëmijëve.

Këto programe dhe nisma të mbarë Drejtorisë Arsimore përfshijnë:

- Përmirësimi i aksesit ndaj informacionit
 - Të informojë rreth programeve të Drejtorisë, shërbimeve, proceseve dhe procedurave, që janë në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias www.philasd.org;
 - Përdorimin e FaceBook_ut dhe Twitter_it dhe punës me mediat partnere tradicionale për të ndarë informacionin me familjet dhe komunitetin;
 - Vënien në zbatim të AskPhliaSD (<http://ask.philasd.org>) – një sistem menaxhimi me bazë në internet, i cili e vë theksin në teknologjinë për të dhënë përgjigje të menjëherëshme për pyetjet që hasen më shpesh;
 - Duke përdorur portalin "Parent and Family", i cili u ofron prindërve një rrugë të re për të qënë në një hap me çdo të re që ndodh në Drejtorinë Arsimore dhe shkollën e fëmijës, nëpërmjet llogarisë personale në këtë portal, që u mundëson përditësimin e informacionit të kontaktit nëse ndryshon, zgjedhjen e mjeteve që mendon se përshtaten më mirë për ta (tekst, telefon ose e-mail), do të përfshihen në përditësimet që ata kanë interes, si dhe kanë akses online në notat dhe frekuentimin e shkollës nga fëmijët e tyre;
- Ofrojnë shumë pika hyrëse për prindërit dhe komunitetin, që mund t'i përdorin për informacion dhe mbështetje në zgjidhjen e problemeve të tyre nëpërmjet:
 - Qendrës Telefonike të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias dhe Zyrës Qendrore Informative 215-400-4000, e cila ofron informacionin e plotë për shërbimet e Drejtorisë, nismave dhe programeve, lehtëson lidhjet midis klientëve dhe zyrave përkatëse të Drejtorisë dhe punon drejtpërsëdrejti me shkollat dhe Rrjetet

Mësimore për adresimin e pyetjeve dhe shqetësimeve të prindërve, nëpërmjet trajtimit individualisht sipas çështjes përkatëse;

- Qendrës së Burimeve për Prindin dhe Familjen, i cila u ofron prindërve mbështetje për zgjidhjen e shqetësimeve dhe zbulimin e rrugëve më të mira për edukimin e fëmijëve, ndihmon prindërit për njohjen e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, informon për politikat e Drejtorisë, programet, procedurat dhe shërbimet, informon për programet dhe burimet me bazë komunitare dhe organizon një mori seminaresh dhe takimesh.
- Koordinatorët e Prindit, të cilët midis shumë funksioneve të tyre asistojnë shkollat në zgjerimin e përfshirjes së prindërve dhe ndërtimin e një lidhjeje sa më të fortë shkollë-familje, mbështesin prindërit në zgjidhjen e shqetësimeve të tyre, duke i trajtuar rast pas rasti, veprojnë si ndërlidhës midis zyrës qëndrore/personelit të shkollës dhe familjeve, mbledhin informacion të shpërndarë për shërbimet, organizojnë dhe lehtësojnë seminarët për prindërit dhe panairët informuese, ndihmojnë shkollat në formimin e Këshillit Konsultativ të Shkollës dhe ofrojnë shërbime dhe ndihmesa të tjera sipas nevojave të ndryshme të familjeve.
- Përdorimit takimeve të Komisionit të Reformës Shkollore për Strategjinë, Politikën dhe Përparësitë, për t'ju drejtuar të gjithë grupeve të interesuara, përfshirë prindërit, nxënësit, personelin dhe komunitetin, për marrjen e mendimeve, ideve të reja dhe opinionëve, për politikën dhe përparësitë e Drejtorisë Arsimore.
- Fuqizimit të përfshirjes të familjes dhe komunitetit në vendimmarrjet e shkollës, përmes zgjerimit të përdorimit të Këshillave Konsultativë të Shkollave- një trupë këshillimore që siguron përfaqësimin e gjerë në diskutimet e çështjeve që ndikojnë të gjithë shkollën. Duke sjellë sëbashku përfaqësuesit e zgjedhur nga të gjithë grupet e interesit: prindërit (që kanë shumicën në SAC), drejtuesit e shkollës dhe personelit, partnerët e komunitetit dhe nxënësit (për shkollat e mesme), SAC-et ofrojnë platformën e diskutimit dhe bashkëpunimit për garantimin e suksesit të të gjithë nxënësve.
- Garantimit që familjet shumëgjuhëshe të kenë akses informacioni, mbështetje dhe përfshirje të prindërve në oportunitetet nëpërmjet:
 - Qendrës së Drejtorisë Arsimore për Përkthimet dhe Interpretimet, e cila ofron një rrjet shërbimesh dhe mjetesh për lehtësimin e komunikimit me familjet shumëgjuhëshe, përfshirë shërbimin telefonik në mbi 170 gjuhë dhe dialekte të ndryshme, përkthimin e dokumentave të Drejtorisë Arsimore dhe ato specifike për shkollat, mbajtjen e të dhënave të dokumentave dhe përkthimeve online për nëntë prej gjuhëve më të folura në Drejtorinë tonë Arsimore (Spanjisht, Kineze, Arabe, Vietnameze, Frënge, Khmer, Ruisht, Shqip dhe Nepali).
 - Zyra e Mbështetjes së Familjeve Shumëgjuhëshe, e cila ndihmon familjet imigrante në krijimin e një komunikimi të vazhdueshëm me shkollën dhe në njohjen me informacionet e Drejtorisë Arsimore në gjuhën amtare, nëpërmjet shërbimeve me Këshilltarët Dygjuhësh, ofron përkthime dhe interpretime në takimet e prindit, konferencat dhe ngjarjeve që lidhen me veprimtarinë e Drejtorisë Arsimore, krijon

bashkëpunime me organizatat që janë në shërbim për imigrantët dhe refugjatët dhe mbështetin familjet në seminarët e prindit dhe trajnimeve të kategorive të imigrantëve dhe refugjatëve, të quajtura Vagonët e Mirëseardhjes (Welcome Wagons). Vagonët e Mirëseardhjes realizohen në komunitet në kohë të përshtarëshme për prindërit, në gjuhën e tyre amtare. Ato trajtojnë tema të ndryshme që janë të rëndësishme për komunitetin e imigrantëve, përfshirë literaturë, procesi i aplikimit në kolegji, burimet e ndihmave financiare, çështje të punësimit, përfitimet nga sistemi shëndetësor, trajtimi i azmës, mbrojtja nga HIV_i, procesi tranzitor në SH.B.A, asimilimi kulturor dhe konfliktet prind/fëmijë, praktikat e mirërritjes dhe disiplina ndaj fëmijëve, njohja dhe trajtimi i depresionit, njohja e dhunës në familje dhe mbrojtja nga abuzimi i fëmijëve.

- Duke punuar nga afër me drejtuesit e prindërve, familjet dhe pjesët e interesuara të komunitetit, për rritjen e vemëndjes ndaj rëndësisë të përfshirjes së tyre në Shkollë e në nivel Drejtorie Arsimore dhe nxitjes së tyre për ndërtimin e marrëdhënieve me mësuesit, drejtorët dhe personelin e shkollës, ndjekjen e shkollave të mbrëmjes dhe takimet prind-mësues, komunikimi i vazhdueshëm me shkollat, vizitat në klasën e fëmijës, pjesëmarrja në ngjarjet dhe takimet shkollore, vullnetarizmi në shkollë, bashkimi me grupet e prindërve dhe marrja e përgjegjësisë drejtuese.

PJESA II. KERKESAT STATUTORE

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS pranon të zbatojë kërkesat e mëposhtëme statutore:

- Drejtoria Arsimore do të zbatojë programet, aktivitetet dhe procedurat për përfshirjen e prindërve në shkollat e tyre, në zbatim të seksionit 1118 të Aktit Mësimor për Shkollat Tetëvjeçare dhe të Mesme (ESEA), të Title I programet e Pjesës A (Part A programs). Këto programe, aktivitete dhe procedura do të planifikohen dhe do të vihen në zbatim në konsultime me prindërit e fëmijëve pjesëmarrës.
- Në zbatim të seksionit 1118, Drejtoria Arsimore do të punojë me shkollat e saj për garantimin që politikat e saj për përfshirjen e prindërve në nivel shkolle, përputhen me kërkesat e seksionit 1118(b) të ESEA_s, dhe çdo komponent i përfshirë në lidhjen shkollë-prind, është në përputhje me seksionin 1118(d) të ESEA_s.
- Në zbatimin e Title I, Pjesës A kërkesat e përfshirjes së prindit sa më tepër që është e mundëshme, Drejtoria Arsimore dhe shkollat e saj, do të ofrojnë të gjitha mundësitë për pjesëmarrjen e prindërve me kufizime në gjuhën Angleze, prindër me paaftësi dhe prindër që kanë migruar, duke ofruar informacion dhe dëftesat shkollore, siç edhe kërkohet nga seksioni 1111 i ESEA_s, në një format të kuptueshëm dhe uniforme, si edhe në formate alternativë sipas kërkesave, dhe aty ku mundësohet në gjuhën që prindi e kupton më mirë.
- Drejtoria Arsimore do të përfshijë në vendimmarrjen e shkollave, prindërit e fëmijëve që marrin shërbime të Title I, Pjesa A, se si është shpenzuar 1 përqind i fondeve të Title I, Pjesës A, të dedikuara për përfshirjen e prindit dhe familjes, dhe do të garantojë, që jo

më pak se 95 përqind i këtij 1 përqindëshi do të shkojë në shkolla për aktivitetet e prindërve, sipas marrëveshjeve midis prindërve dhe shkollave dhe të miratuar nga Këshilli Konsultativ i Shkollës (SAC)

- Drejtoria Arsimore do të drejtohet nga këto përcaktime statutores për përfshirjen e familjes dhe pret që shkollat e Title I të vazhdojnë programe, aktivitete dhe procedura, në përshtajë me këtë përcaktim:

Përfshirja e prindit dhe familjes, nënkupton pjesëmarrjen e prindërve në një komunikim të dyanshëm, të rregullt dhe me synime në procesin e mësimnxënies dhe aktivitetet e tjera shkollore, përfshirë garantimin—

- (A) *që prindërit luajnë një rol tërësor në asistimin e mësimnxënies të fëmijëve të tyre;*
- (B) *që prindërit janë të nxitur të lozin një rol aktiv në edukimin e fëmijëve të tyre në shkollë;*
- (C) *që prindërit janë bashkëpunorë të plotë në edukimin e fëmijëve të tyre dhe janë të përfshirë, në mënyrën e duhur në marrjen e vendimeve dhe në komitetet konsultativë, që të asistojnë në edukimin e fëmijëve të tyre;*
- (D) *të marrin pjesë në aktivitetet e tjera, të tilla si ato që përshkruhen në seksionin 1118 të ESEA.*

PJESA III. PËRSHKRIM SE SI DREJTORIA DO TË ZBATOJË KËRKESAT E KOMPONENTEVE TË POLITIKËS SË PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE NË SHKALLË DREJTORIE

1. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të ndërmarrë veprimet e mëposhtëme për përfshirjen e prindërve në planin që shtrihet në gjithë drejtorinë sipas seksionit 1112 të ESEA_s:
 - Të gjitha shkollat e Drejtorisë do të ftohen të caktojnë së paku një pjestar familjeje për t'u përfshirë në Ekipin e Veprimit të Përfshirjes të Familjes dhe Komunitetit, të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias (FACE-A-Team) për të marrë pjesë në trajnime dhe të sjellë këtë përvojë në shkollën e tyre.
 - Pjestarët e Ekipit FACE-A-Team, në takimet e zhvilluara nga Drejtoria Arsimore, ose ato rajonale, do të ftohen të japin mendimet e tyre në politikën dhe planin e Drejtorisë Arsimore për përfshirjen e prindit dhe familjes.
 - Drejtoria Arsimore do të dërgojë një direktivë (firmosur prej Superintendentit) te Ndihmësit e Superintendentit dhe Drejtorët, për shpërndarjen e Politikës së Drejtorisë tek prindërit.
 - Politika e përmirësuar do të vendoset online për rishikim dhe komente nga prindërit.
 - Një letër për prindërit do të shoqërojë këtë politikë, për të informuar prindërit rreth rrugëve të tjera për sugjerimet dhe mendimet, përfshirë parashtrimin të këtyre sugjerimeve në pyetësorët online, me telefon, ose në takimet e Ekipit FACE-A-Team, në zonat e tyre.

2. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të ndërmarrë veprimet në vazhdim për përfshirjen e prindërve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të shkollës, sipas seksionit 1116 të ESEA_s:

- Deri në 1 Qershor 2015 së paku 50% e shkollave të Drejtorisë Arsimore do të kenë Këshillat Konsultativë të Shkollës (SAC) të përbërë prej prindërve, nxënësve¹, administratorëve të shkollave, personelit dhe partnerëve të komunitetit, ku prindërit do të zënë numrin më të madh të vendeve të SAC². Përgjegjësia e parë e SAC, është të japë mendime në Planin e Përgjithshëm të Shkollës dhe buxhetin e saj.
- Përfaqësuesit e caktuar të Drejtorisë Arsimore do të punojnë nga afër me drejtuesit e prindërve dhe Zyrën e Përfshirjes të Familjes dhe Komunitetit, duke ofruar trajnime në nivele shkolle, rajonale apo drejtorie, për aspekte të ndryshme të Title I, përfshirë kuptimin e të dhënave të shkollës, planet gjithëpërfshirëse të shkollës dhe procesin e hartimit të buxhetit.
- Këshillave Konsultativë të Shkollave do t'u ofrohen kualifikime profesionale (personelit të shkollës, nxënësve, familjeve dhe partnerëve të komunitetit) që të ndihmojnë kuptimin e roleve dhe përgjegjësi të të gjithë pjestarëve të këtij procesi.
- Qendra e Përkthimeve dhe Interpretimeve të Drejtorisë dhe Zyra e Mbështetjes së Familjeve Shumëgjuhëshe, do të ofrojnë shërbime gjuhësore për prindërit, gjuha amtare e të cilëve është e ndryshme nga ajo Angleze.

3. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të ndërmarrë koordinimet e nevojshme, asistencën teknike dhe mbështetje të tjera në vazhdim për të asistuar shkollat e Title I, Pjesa A, në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve prindërore efektive, për përmirësimin e arritjeve mësimore të nxënësve dhe performancës së shkollave:

- Në bashkëpunim me grupet e prindërve, ofron seminare në shkollat për përfshirjen e prindërve.
- Nëpërmjet Universiteit të Prindit, ofron trajnime për prindërit, përfshirë, por pa u kufizuar-në lexim, matematikë, shkencë, përgatitje për testet e PSSA dhe Keystone.
- Ofron seminare të prindërve për sigurinë e shkollave, ndryshueshmëritë kulturore, zgjidhjen e konflikteve, si të përfshihesh shkollë dhe çështje të tjera sipas kërkesave.
- Trajnon prindërit e Ekipit FACE-A-Team, që të shërbejnë si ndërlidhës midis drejtorëve dhe SAC_ut, në nismat në nivel Drejtorie dhe Rrjeti Mësimor.
- Në përputhje me Planin e Veprimit 2.0 të Drejtorisë Arsimore, nxit familjen dhe prindin për të takuar mësuesit dhe drejtorët.

4. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të koordinojë dhe integrojë strategjitë e përfshirjes së prindit në Title I, Pjesa A me strategji të përfshirjes së prindit sipas programeve të tjerë në vazhdim: Head Start, Bright Futures, dhe ELECT, nëpërmjet:

¹ E detyrueshme për shkollat e mesme

² Në shkollat fillore dhe tetëvjeçare, prindërit zënë 51% të vendeve të lejueshme prej 7 deri 21, për votim në SAC. Në shkollat e mesme, minimumi 51% i vendeve të lejueshme për votim në SAC, ndahet midis prindërve dhe nxënësve, nga ku prindërit zënë së paku dy herë më tepër vende se nxënësit, minimumi është 6 prindër, 3 nxënës.

- Rritjes së bashkëpunimit , për angazhimin e prindërve, ndërmjet rritjes së përgjegjësi të personelit të programeve Pre-K e ELECT dhe Zyrës së Familjes dhe Komunitetit.
- Duke i ftuar prindërit e nxënësve të Pre-K për pjesëmarrje në takimet dhe aktivitetet e Drejtorisë.
- Duke ofruar shërbime përkthimi në programet parashkollore për familjet, ku gjuha e tyre amtare është e ndryshme nga Anglishtja.

5. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIA** do të drejtojë një pyetësor vjetor për ndikimin e Prindit dhe Kujdestarit në nivel shkolle e Drejtorie, nga ku do të nxjerrë të dhëna për mendimet dhe vërejtjet e tyre sipas kërkesave të pyetësorit.

Rezultatet e pyetësorit do përdoren për identifikimin e problemeve që pengojnë pjesëmarrjen më të gjërë të prindërve në aktivitetet që përfshijnë prindërit (me fokus të veçantë te familjet me probleme ekonomike, me paaftësi, me kufizime në Anglisht, me nivel të ulët arsimor, ose që i përkasin rracave dhe minoriteteve etnike të ndryshme). Drejtoria Arsimore do ti përdorë rezultatet e dala nga pyetësori në politikat e saj të përfshirjes së prindërve dhe do të rishikojë nëse është e nevojshme (edhe me pjesëmarrjen e prindërve) politikat e saj të përfshirjes së prindit.

6. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIA** do të realizojë aktivitetet e mëposhtëme për një fuqizim të përfshirjes së prindërve në lidhjen shkollë-prind, në mënyrë që të garantojë përfshirje efektive të prindërve dhe të mbështesë një bashkëpunim midis shkollave, prindërve dhe komunitetit, për përmirësimin e arritjeve mësimore të nxënësve:

- A. Drejtoria Arsimore, me asistencën e zyrave të saj administrative, do të ndërmarrë veprimet e mëposhtëme, për të afruar ndihmë për prindërit e fëmijëve që u shërbehet nga Drejtoria Arsimore ose shkolla, në kuptimin e çështjeve të tilla si në vijim:

- përbajtja e standardeve mësimore të Shtetit;
 - Standardet shtetërore të arritjeve mësimore të nxënësve;
 - Vlerësimet Shtetërore dhe Lokale, përfshirë vlerësimet alternative;
 - Kërkesat e Title I, Pjesa A;
 - Si të monitorohet progresi i fëmijëve të tyre; dhe
 - Si të punoni me edukatorët.
- Zyra e Zhvillimit të Granteve dhe Pajtuëshmërisë /Title I , do të jetë e gatëshme të bashkëpunojë me zyra të ndryshme dhe grupet e prindërve, për të ofruar seminare dhe prezantime, rreth kërkesave të Title I dhe të drejtat e prindërve për njohje, sipas aktit të Edukimit të Shkollave Tetëvjeçare dhe të Mesme.
 - Rekomandohet që drejtorët, kur është e mundur, të përfshijnë edhe prindërgjatë ditëve të kualifikimit profesional që zhvillohet në shkollë.
 - Sponsorizojë dhe nxitë shkollat, për mbështetjen e pjesëmarrjes së prindërve në konferenca dhe seminare, të tilla si konferenca vjetore e

Këshillave Konsultativë të Prindërve të gjithë Shtetit, Konferenca Vjetore e Përfshirjes së Familjes (PA Coalition for Parent Involvement) dhe të tjera.

- Të kërkojë nga prindërit që dëshirojnë të marrin pjesë në konferencat e prindit që trajnimet të plotësohen në shkollë dhe/ose në nivel Drejtorie. Verifikimi do të bëhet: 1) firmosja në fletën e pjesëmarrjes(s); 2) rendi i ditës; dhe 3) kopja e dokumentave të shpërndara.
 - Të garantojë që çdo prind që është zgjedhur për pjesëmarrje në Title I PAC në nivel shteti ose kombëtar, të ndjekë rregullisht takimet e drejtorisë -District's FACE-A-Team dhe të paraqesë një raport (me gojë ose me shkrim).
 - Të ofrojë për prindërit informacion në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.
 - Të zgjerojë aplikimet, të ofrojë seminare në gjuhën amtare të prindërve, gjuha e të cilëve është e ndryshme nga ajo Anglisht.
 - Të shpërndajë për prindërit materiale nga Zyra e Kurrikulës Mësimore, si edhe nga zyra të tjera, të cilat do të jenë të dobishme gjatë përdorimit në shtëpi, përfshirë, në masën e mundëshme, të përkthimeve.
- B. Drejtorja Arsimore, me asistencën e shkollave të saj, do të ofrojë materiale dhe trajnime që ndihmojnë punën e prindërve me fëmijët e tyre, për përmirësimin e arritjeve mësimore të tyre, të tilla si seminare për shkrim- leximin dhe teknologjinë dhe sipas rasteve, për angazhimin e prindërve adoptues nëpërmjet:
- Zbatimit të Universitetit të Prindit në të gjithë qytetin, ku të ofrojë një larmi tematikash mësimore për prindërit nga personeli i Drejtorisë Arsimore dhe ofruet të tjerë, përfshirë se si të mbështetet një fëmijë në shkollë dhe literaturë për kompjuter.
 - Të mbështesë krijimin e Këndeve/Qëndrave/Dhomave të prindit në shkolla.
 - Të ofrojë trajnim për literaturën e kompjuterit për prindërit, përfshirë përdorimin e portalit Prindi dhe Familja, si mjet për monitorimin e arritjeve të fëmijës.
 - Të mbështesë shkollat në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve me bazë shkolle, të tilla si, netët familjare të familjes për shkrim-leximin dhe matematikën dhe seminare të tjera që ndihmojnë prindërit të kuptojnë se si të mbështesin fëmijët e tyre në mësim, me asistencën e zyrave të duhura në Drejtorinë Arsimore.
 - Të ofrojë kur është e mundëshme që këto seminare dhe materiale të jenë edhe në gjuhë të tjera përveç gjuhës Angleze.
- C. Zyra e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit, do të jetë e gatëshme të trajtojë seminare kualifikuese për mësuesit, personelit që u shërben nxënësve, drejtorëve dhe personelit tjetër, se si të kontaktojnë, komunikojnë dhe punojnë me prindërit si partnerë të barabartë, në vlerën dhe dobinë e kontributit të prindërve, dhe se si të zbatojnë dhe koordinojnë programet e prindërve dhe ndërtojnë lidhje të forta midis prindërve dhe shkollave, nëpërmjet:

- Me ndihmën e prindërve do të zhvillojmë mundësi për kualifikimin profesional të drejtorëve dhe administratorëve të tjerë, se si të zhvillohet bashkëpunimi i premtuar me prindërit.
 - Duke sugjeruar që të gjithë prindërit janë të ftuar në rishikimin e termave të Politikës së Përfshirjes së Prindërve të Title I për shkollat dhe Bashkëpunimit Prind-Shkollë (sipas nevojave).
- D. Drejtoria Arsimore duke i shtrirë mundësitë e saj do të koordinojë dhe integrojë programet e përfshirjes së prindërve dhe aktivitetet me Head Start, Bright Futures, ELECT dhe programe të tjerë, si dhe do të drejtojë aktivitete të tjera, të tilla si qendrat e prindit, që nxitin dhe mbështetin prindërit në pjesëmarrje të edukimit të fëmijëve të tyre nëpërmjet:
- Rritjes së bashkëpunimit midis personelit përgjegjës të përfshirjes prindërve të programeve Pre-K dhe ELECT dhe Zyrës për Përfshirjen e Familjes dhe Komunitetit.
 - Rekrutimit të prindërve të nxënësve të Pre-K për të marrë pjesë në takimet, ngjarjet dhe aktivitetet e Drejtorisë Arsimore.
 - Kryerjes së shërbimeve të përkthimit për programet parashkollore, për familjet gjuha e të cilave është e ndryshme nga ajo Angleze.
- E. Drejtoria Arsimore do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme që të garantojë se informacioni që lidhet me programet e shkollave dhe ato të prindërve, takimet dhe aktivitetet e tjera, të dërgohet tek prindërit e fëmijëve pjesëmarrës, në një gjuhë të kuptueshme dhe të thjeshtë, përfshirë edhe në formate të tjera n.q.s kërkohet dhe aty kur janë mundësitë, në gjuhën që prindërit e kuptojnë më mirë:
- Në përshtatje me mundësitë praktike të ofrojë komunikim në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.
 - Postojë komunikimin e prindërve në faqet e uebsajtit të Drejtorisë Arsimore dhe Facebook.
 - Garantojë që në komunikimin me prindërit, Drejtoria të ketë edhe një numër telefonik për të gjitha kërkesat e prindërve.
 - Të ndajë informacionet e rëndësishme me Qendrën Telefonike të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias dhe Qendrën Kryesore Informative me numër 215-400-4000, Koordinatorët e Prindit dhe Asistentët Këshilltarët Dygjuhësh, në mënyrë që ata mund të ndajnë informacionin me familjet dhe qartësojnë informacionet e rëndësishme të Drejtorisë.
 - Organizojë takimet dhe seminarët e prindërve dhe komunitetit, ku trajtohen shumica e çështjeve të rëndësishme.
 - Kërkojë nga partnerët e komunitetit, përfshirë bibliotekat, qendrat argëtuuese, organizatat e komunitetit dhe ato me bazë fetare, të asistojnë në përhapjen e informacionit.
 - Ofrojë shërbime gjuhësore për familjet me gjuhë amtare të ndryshme nga Anglishtja, nëpërmjet shërbimeve nga telefoni, ose në mënyra të tjera të mundshme.

PJESA IV. KOMPONENTET E POLITIKËS TË DREJTORISË ARSIMORE PËR PËRFSHIRJEN E PRINDIT DHE FAMILJES

- Përfshirja e prindërve në trajnimet profesionale të mësuesve, drejtorëve dhe personelit tjetër, për përmirësimin e efektivitetit të këtyre trajnimeve;
- Ofrojë literaturën e duhur për trajnimin e prindërve nga fondet e Title I, Even Start dhe Family Literacy;
- Duke paguar shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme që shoqërojnë aktivitetet e prindërve, përfshirë transportin dhe kostot e kujdesit për fëmijët, për të mundësuar pjesëmarrjen e prindërve në aktivitetet shkollore, sipas mundësive buxhetore;
- Duke trajnuar prindërit, që të rritin përfshirjen e prindërve të tjerë;
- Duke i organizuar takimet e shkollës në orare të ndryshme, ose duke zhvilluar takime në shtëpi midis mësuesve, ose edukatorëve të tjerë që punojnë me fëmijët, me prindërit të cilët e kanë të pamundur ndjekjen e këtyre takimeve në shkollë; në mënyrë që të maksimalizohet përfshirja e familjes në edukimin e fëmijëve të tyre;
- Duke bërë kërkime, adoptime dhe zbatime të modeleve, të cilat rritin përfshirjen e prindit;
- Duke krijuar një këshill konsultativ të prindit për përfaqësimin e prindërve të të gjithë drejtorisë, i cili jep mendime për të gjitha çështjet që lidhen me përfshirjen e prindit në programet e Title I, Pjesa A;
- Duke zhvilluar rolet e duhura për organizatat e komunitetit dhe të biznesit, në aktivitetet ku përfshihen familjet; dhe
- Duke ofruar edhe mbështetje të tjera të arsyeshme, ndaj kërkesave të prindërve për aktivitetet e përfshirjes së familjes, sipas seksionit 1118.

PJESA V. ADOPTIMI

Kjo Politikë e Drejtorisë për Përfshirjen e Familjes është zhvilluar dhe është miratuar në bashkëpunim me prindërit e nxënësve pjesëmarrës në programet e Title I, Pjesa A, siç edhe evidentohet nga takimet e mbajtura në datat 14, 23, dhe 30 Janar, 6 Shkurt, 15 Maj dhe 2 Qershor të vitit 2014.

Kjo politikë është adoptuar nga **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** në datën 19 Mars 2015 dhe do të jetë efektive për periudhën e një viti shkollor. Drejtoria Arsimore do t'a shpërndajë këtë politikë të të gjithë prindërit brenda datës **30 Prill 2015**.

(Firma e Zyrtarit të Ngarkuar)

(Data)

References:

NCLB: 20 U.S.C. §§ 6316(b)(7), (8)

C.F.R. 34 C.F.R. § 200.36

State School Code: 24 P.S. § 1-101 *et seq.*, including 24 P.S. §§ 6-693, 6-696